



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Monitorimi i Prokurimit Publik në Ndërmarrjet Publike: Termokosi, KRU Bifurkacioni, Trafiku Urban dhe Pallati i Rinisë

Dhjetor, 2023





QEVERISJE E MIRË

AUTOR:

Ardit Dragusha



Vizitoni ueb faqen tonë
www.dplus.org

Mësoni më shumë rreth publikimeve tona të fundit,
lajmeve dhe infografikave online.



Na gjeni në Facebook
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Na gjeni në LinkedIn
[@democracy-plus](https://www.linkedin.com/company/democracy-plus)



Na gjeni në Twitter
[@democracy_plus](https://twitter.com/democracy_plus)



Na gjeni në Youtube
[@DemocracyPlus](https://www.youtube.com/DemocracyPlus)

Zyret tona:

Rruga Bajram Kelmendi, Nr. 92, Kati V
Prishtinë, 10000
Kosovë

+383 (0) 38 749 288
info@dplus.org



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Deklarata mohuese: Ky raport është botuar me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Demokraci Plus (D+) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian. Projekti “Qeverisje e mirë: prokurim publik dhe politik-bërje e avancuar” i financuar nga BE, implementohet nga Demokraci Plus (D+).

Përmbajtja

Lista e Shkurtesave	6
Hyrje	7
Metodologjia	8
1. Termokos	9
1.1. Ndërtimi i objektit të ri administrativ dhe renovimi i hapësirave përcjellëse	9
1.2. Tejkalimi i buxhetit	11
2. Bifurkacioni	13
2.1. Zvogëlimi i humbjeve të ujit dhe digjitalizimi i shërbimeve.....	13
3. Trafiku Urban	15
3.1. Furnizimi me kompjuter.....	15
4. Pallati i Rinisë	17
4.1. Renovimi dhe funksionalizimi i Fontanës në Pallatin e Rinisë	17
Të gjeturat	19
Rekomandimet.....	20

Lista e Shkurtesave

AK ➤ Autoriteti Kontraktues

DT ➤ Dosja e Tenderit

GOE ➤ Grupi i Operatorëve Ekonomikë

ISO ➤ Organizata Ndërkombëtare për Standardizim

KRM ➤ Kompania Rajonale e Mbeturinave

LPP ➤ Ligji për Prokurimin Publik

NP ➤ Ndërmarrje Publike

NPL ➤ Ndërmarrje Publike Lokale

OE ➤ Operatori Ekonomik

OShP ➤ Organ Shqyrtues i Prokurimit

ShA ➤ Shoqëri Aksionare

Hyrje

Në vazhdim të monitorimit të prokurimit publik në ndërmarrje publike, Demokraci Plus (D+), nxjerrë raportin e tretë për vitin 2023, ku janë përfshirë katër ndërmarrje publike, tri lokale dhe një regjionale. Ndërmarrjet e përfshira në këtë raport kryjnë funksione të rëndësishme publike, si ngrohjen lokale qendrore, transportin publik urban, furnizimin me ujë të pijshëm dhe mbledhjen e ujërave të zeza.

Ligji për Prokurimin Publik (LPP), vlen për të gjitha organizatat buxhetore, duke përfshirë edhe ndërmarrjet publike, ndaj edhe hulumtimi i aktiviteteve të prokurimit të këtyre ndërmarrjeve është bazuar në rregullat dhe përgjegjësitë që dalin nga ky ligj.

Raporti i përfshinë katër tenderë të këtyre ndërmarrjeve publike: ndërtimi i objektit të ri administrativ dhe renovimi i hapësirave përcjellëse të Termokosit, zvogëlimi i humbjeve të ujit dhe digjitalizimi i shërbimeve nga Bifurkacioni, furnizimi me kompjuter për nevojat e Trafikut Urban, si dhe renovimi dhe funksionalizimi i Fontanës në Pallatin e Rinisë.

Këta katër tenderë janë të natyrave të ndryshme teksa së bashku arrijnë vlerën 2,670,117.60 euro. Në të gjithë këta tenderë janë gjetur shkelje të LPP-së, si:

- NP “Termokos”, kërkoi që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikatën OHSAS 18001, e cila nuk përdoret që nga viti 2021. Kjo ndërmarrje, shkurtoi afatin për dorëzimin e ofertave dhe nënshkroi kontratën për 233,753.60 euro më shumë se që ishte vlera e parashikuar.
- KRU “Bifurkacioni”, shkurtoi afatin për dorëzimin e ofertave, dhe kërkoi zhvillimin e aplikacionit mobil, duke mos poseduar kodin burimor të sistemit të faturimit, që është e pamundur të bëhet nga kushdo tjetër përveç kompanisë e cila e posedon këtë kod.
- NP “Trafiku Urban”, vendosi specifika teknike të veçanta për blerjen e iPhone 14 Pro Max dhe iPad 14, gjë e cila ndalohej me LPP.
- NP “Pallati i Rinisë”, nuk bëri vlerësimin e ofertave sipas Dosjes së Tenderit, duke rekomanduar për kontratë një operator ekonomik i cili nuk kishte përmbushur kërkesat e tenderit.

Metodologjia

Hartimi i këtij raporti është bazuar në të dhënat mbi tenderët të cilët publikohen në platformën elektronike e-Prokurimi, ku pastaj janë selektuar një numër tenderësh nga ndërmarrjet publike. Selektimi i tyre është bazuar në disa indikatorë të rrezikut, siç janë: a) shkurtimi i afateve kohore; b) përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë; c) kur çmimi i kontratës është më i lartë se vlera e parashikuar, dhe d) kur ka qenë vetëm një ofertues i përgjegjshëm.

Hulumtimi është bazuar në tenderë të cilët janë zhvilluar në pjesën e dytë të vitit, teksa në fokus kanë qenë tenderët për të cilët ka pasur disa ankesa nga ana e operatorëve ekonomikë.

Me qëllim të kompletimit të dokumenteve të nevojshme për hulumtim, D+ ka dërguar kërkesat për qasje në dokumente publike në ndërmarrjet e përzgjedhura, duke u bazuar në Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, si dhe mbledhjen e dokumenteve të nevojshme për monitorim.

Raporti është finalizuar me analizimin e këtyre dokumenteve, ndërsa para publikimit, raporti i është dërguar për lexim edhe autoriteteve kontraktuese të përfshira në raport.

1. Termokos

1.1. Ndërtimi i objektit të ri administrativ dhe renovimi i hapësirave përcjellëse

Ndërmarrja publike “Termokos” që ka mision furnizimin lokal të ngrohjes qendrore në Prishtinë, në vitin 2019 nisi procedurat për ndërtimin e një objekti të ri për stafin administrativ, pasi objekti ekzistues u vlerësua se nuk i plotësonte kushtet elementare për punë. Ky projekt u planifikua të financohej me mjete vetanake të ndërmarrjes, teksa projekti zbatues¹ parashihte ndërtimin e objektit të ri me sipërfaqe 3,913.20m².

Kjo ndërmarrje nisi procedurat e prokurimit për dy tenderë “Mbikëqyrja e ndërtimit të objektit dhe renovimi i hapësirave përcjellëse” dhe “Ndërtimi i objektit dhe renovimi i hapësirave përcjellëse” gjatë viteve 2020-2021, por nuk arriti të nënshkruajë kontrata për shkak të ankesave të shumta me dy tenderët që përfunduan në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Tenderi i parë për ndërtimin e objektit dhe renovimit të hapësirave përcjellëse ishte hapur në fund të vitit 2020, teksa u anulua në gusht të vitit 2022, me arsyetimin se një vendim i OSHP-së e kërkonte anulimin e këtij aktiviteti. Në fakt, lënda me nr. 372/21 ishte ankesë e një operatori ekonomik kundër “Termokosit”, dhe kjo lëndë u trajtua vetëm nga eksperti shqyrtues, i cili erdhi në përfundim se AK nuk i kishte vlerësuar ofertat konform LPP-së. Lënda nuk pati vendim meritore nga OSHP, për faktin se ky organ kishte mbetur pa bord gjatë kohës së paraqitjes së ankesës, ndërkohë bordi i ri kishte vendosur ta hedh poshtë ankesën për shkak të vjetërsisë.

Në mars të vitit 2023, “Termokos” hapi përsëri tenderin për ndërtimin e objektit të ri administrativ dhe renovimit të hapësirave përcjellëse², me Dosjen e Tenderit që përmbajti kritere diskriminuese, duke kërkuar nga operatorët ekonomikë që të jenë të pajisur me një certifikatë e cila nuk është e vlefshme nga viti 2021. Fillimisht, AK caktoi afatin për dorëzimin e ofertave në 20 ditë. Ky afat i shkurtuar nga 40 ditë sa është afati minimal kur është kontrata publike me vlerë të madhe, u bë me arsyetimin se lënda ka qenë e bllokuar në OSHP, për më shumë se dy vite dhe se kjo kontratë paraqet urgjencë të AK-së për ri-tenderim.

Përkundër faktit se rregullat e posaçme të LPP-së e mundësojnë shkurtrimin e afateve kohore në raste urgjente, AK është dashur të këtë parasysh kompleksitetin e prokurimit (paramasa kishte mbi 600 pozicione) dhe numrin e lartë të kërkesave teknike/profesionale. Kjo pasi bëhet fjalë për kontratë për punë të vlerës së lartë dhe në këtë mënyrë është dashur të iu mundësojë operatorëve ekonomikë kohë të mjaftueshme për përgatitjen e ofertave.

Shkurtimi i afatit ligjor për dorëzimin e ofertave në 20 ditë, ndonëse kjo kontratë parashikohet të përfundojë brenda 18 muajve, ka mundur të ndikojë në numrin e ulët të operatorëve të interesuar për ofertim, duke qenë se vetëm tre operatorë dorëzuan oferta.

1 Projekti zbatues është punuar nga studio projektuese “Sigma Construction”. Plani Zhvillimor i N.P Termokos 2022 – 2031. Mund të gjendet në https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Draft%20-%20Plani%20%20Zhvillimor%20%202022-2031%20NO%20Termokos_Kons.%20Publik.pdf (qasur për herë të fundit me 23.10.2023).

2 Nr. i prokurimit NP Termokos.sha-23-1791-5-1-1

Gjatë fazës së ofertimit, një operator ekonomik kërkoi nga AK zgjatjen e këtij afati, duke e konsideruar këtë afat si shumë të shkurtër për analizimin dhe përgatitjen e specifikimit teknik pasi që tenderi ishte shumë voluminoz duke u thirrur në nenin 44.2 të LPP-së i cili thotë:

Gjatë një prokurimi që zbaton procedurën e hapur, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve që është

- 2.1 kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se dyzet (40) ditë; dhe**
- 2.2. kur kontrata përkatëse nuk është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se njëzet (20) ditë.**

Në përgjigjen ndaj kërkesës për sqarim të Dosjes së Tenderit, AK e arsyetoi përsëri shkurtimin e afatit me nevojën urgjente për këtë aktivitet duke përmendur vonesën në OShP. Në adresën e AK-së u drejtuan edhe dy kërkesa tjera që kishin të bëjnë me Dosjen e Tenderit, konkretisht largimin e kriterit për certifikatën OHSAS 18001 dhe rritjen e buxhetit të planifikuar për këtë aktivitet të prokurimit. Kjo pasi ishte i njëjtë me të vitit 2021, dhe se kjo shumë e parashikuar nuk faktorizonte ndryshimin e rrethanave dhe rritjes së çmimeve gjatë dy viteve të kaluara.

AK refuzoi largimin e kërkesës për certifikatë OHSAS 18001 nga Dosja e Tenderit, duke argumentuar se të gjitha kompanitë përveç atyre të shërbimeve mund të pajiseshin me këtë certifikatë, dhe e njëjta rekomandohej veçanërisht për kompanitë në sektorin e ndërtimit, ndaj mbeti në fuqi kërkesa që kompanitë të kenë në stafin e tyre minimum një person të trajnuar dhe certifikuar me këtë standard.

AK refuzoi edhe kërkesën tjetër për rritjen e buxhetit të planifikuar për këtë kontratë, duke dhënë përgjigje se kjo ndërmarrje kishte angazhuar ekspert të jashtëm profesional për hartimin e specifikacionit teknik, i cili kishte bërë hulumtimin e tregut në kohën e tashme për paramasën, ndaj AK konsideronte vlerën e ndarë për këtë aktivitet të prokurimit si vlerë reale që i përputhej rrethanave të tregut.

Me dhënien e përgjigjes për informata sqaruese ose shtesë, AK publikoi emrin e operatorit ekonomik, duke shkelur nenin 45.11 të Rregullores së Prokurimit Publik, që përcakton se autoriteti kontraktues nuk do të zbulojë identitetin e operatorit ekonomik që i ka kërkuar informatat sqaruese.

Kërkesa e AK-së, që operatorët ekonomikë të interesuar të kenë një person për mbrojtje dhe siguri në punë, i cili bazohet në sistemin e vendosur në kompani i cili është trajnuar dhe certifikuar me OHSAS 18001, paraqet kufizim të konkurrencës dhe trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë të përcaktuara me nenin 7 të LPP-së.

OHSAS 18001³ ishte një standard ndërkombëtar për sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, i cili ishte hartuar dhe publikuar tërësisht jashtë kornizës së Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim (ISO) në

3 OHSAS 18001: Occupational Health and Safety Management Systems. Gjetend në <https://isoupdate.com/standards/ohsas18001/> (qasur për herë të fundit me 01.11.2023).

vitin 1999, teksa ishte adoptuar më vonë si standard britanik. Versioni më i ri i këtij standardi ishte publikuar në vitin 2007⁴ ndërkohë, nga viti 2018 ky standard është zëvendësuar plotësisht nga ISO 45001:2018. Kompanitë e certifikuara sipas OHSAS 18001 kishin kohë deri në fund të marsit 2021 të migronin në ISO 45001⁵. Pra, standardi OHSAS 18001 nuk është më i vlefshëm dhe nga shtatori i vitit 2021, dhe asnjë operatorë ekonomikë nuk ka pasur mundësi të pajisjet me këtë certifikatë⁶.

Në këtë mënyrë, AK ka shkelur parimet e prokurimit publik, duke kërkuar një certifikatë profesionale e cila ishte e obligueshme të plotësohej nga të gjithë ofertuesit në mënyrë që të ishin të përgjegjshëm, por kjo certifikatë nuk është e vlefshme dhe askush nuk mund të pajisjet me të nga viti 2021. Vendosija e këtij kriteri, plotësimi i së cilit ishte i pamundur, ka kufizuar konkurrencën dhe barazinë e operatorëve ekonomikë si parime themelore të prokurimit publik. D+ ka kërkuar qasje në ofertën e operatorit ekonomik fitues, për të parë se si është plotësuar ky kriter, por AK ka refuzuar ofrimin e qasjes në ofertën e pranuar.

1.2. Tejkalmi i buxhetit

Në planin përfundimtar të prokurimit për vitin 2023, “Termokos” kishte planifikuar 1,250,000.00 euro për ndërtimin e objektit të ri administrativ dhe renovimin e hapësirave përcjellëse. Në deklaratën e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve, dokument me të cilin aprovohet iniciimi i aktivitetit të prokurimit, AK përmend kodin 77 të planit vjetor të prokurimit, i cili parashihet këtë aktivitet përshkruan këtë aktivitet të prokurimit në vlerë 1,250,000.00 euro.

Kjo shumë u parashikuar për vitin 2023, ndërkohë pjesa e mbetur mbeti për vitin e ardhshëm, ndonëse në deklaratën e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve, ky projekt nuk është plotësuar si shumë vjeçar.

■ FOTOGRAFI 1. Disponueshmëria e fondeve

II.2 DISPONUESHMËRIA E FONDEVE

II.2.1 Deklarata mbi disponueshmërinë e fondeve:

Zyrtari Kryesor Financiar “ZKF” duhet formalisht të sigurojë që fondet janë të disponueshme për prokurimin në fjalë.

[në rast të një autoriteti publik apo një organizate buxhetor]

Zyrtari Kryesor Financiar “ZKF” duhet formalisht të sigurojë që janë përvetësuar mjetet për prokurimin në fjalë në një shumë të mjaftueshme për të përmbushur obligimet financiare që mund të rrjedhin gjatë periudhës së vitit të tanishëm fiskal si rezultat i këtij prokurimi.

A është ky projekt shumë-vjeçar?

Po

Jo

⁴ OHSAS 18001: What is it, how does it work and why use it? Gjendet në <https://advisera.com/45001academy/what-is-ohsas-18001/> (qasur për herë të fundit me 01.11.2023)

⁵ OHSAS 18001 has been withdrawn and replaced by ISO 45001. Gjendet në <https://www.bsigroup.com/en-IN/BS-OHSAS-18001/> (qasur për herë të fundit me 01.11.2023).

⁶ Will OHSAS 18001 Still be Valid after 2021? Gjendet në <https://safetyculture.com/topics/ohsas-18001/> (qasur për herë të fundit me 01.11.2023).

Në këtë aktivitet të prokurimit morën pjesë tre operatorë ekonomikë, teksa për kontratë u rekomandua grupi i operatorëve ekonomikë (GEO) LimitProject Sh.P.K.; Delta – CCD Sh.P.K.; Rinesa Sh.P.K.; Ilea – Gr Sh.P.K.

TABELA 1. Operatorët ekonomikë dhe vlera totale e ofertave

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera totale e ofertës
1.	GEO LimitProject Sh.P.K.; Delta – CCD Sh.P.K.; Rinesa Sh.P.K.; Ilea – Gr Sh.P.K.	2,433,753.60 euro
2.	GEO Nika Pro Ing Sh.P.K.; Pro & Co Group Sh.P.K.; Engineering RK Sh.P.K.	2,186,327.20 euro
3.	GEO Standard Beton Sh.P.K.; Monting Sh.P.K.; Dardaniaa Sh.P.K.	2,169,297.64 euro

Ndonëse në përgjigjen për informata sqaruese, kjo ndërmarrje vlerësoi se vlera e parashikuar e kontratës ishte vlerë reale e cila përputhej me çmimet e tregut, “Termokos” nuk pranoi asnjë ofertë të përgjegjshme brenda çmimit të parashikuar. Në fakt, oferta e GEO fitues tejkaloi vlerën e parashikuar të kontratës për 233,753.60 euro, por u rekomandua për kontratë pasi dy operatorët e tjerë ofertues u shpallën si të papërgjegjshëm.

Para dhënies së kontratës, AK iu drejtua Komisionit Regullativ të Prokurimit Publik (KRPP), me një kërkesë për interpretim, duke sqaruar rrethanat e krijuara, ku oferta e pranuar kishte çmim më të lartë se vlera e mjeteve të ndara për këtë aktivitet.

Në përgjigjen e KRPP-së, u citua nenin 62 i LPP-së, i cili thotë se autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit, kur të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit. Në përgjigje, u theksua se LPP përdor fjalën “mund” dhe jo “duhet”, ndaj nëse AK konstaton se çmimet e ofruara në ofertën më të lirë janë çmime reale të tregut, si dhe mund të sigurojë mjete shtesë duke u siguruar në dëshmi me shkrim nga Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) dhe Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA), atëherë nuk kërkohet anulimi i aktivitetit.

AK vendosi që të vazhdojë me nënshkrimin e kontratës, duke u zotuar se do të sigurojë mjetet shtesë në vlerë 233,753.60 euro nga bordi i drejtorëve, mjete të cilat të cilët do të përfshihen në planifikimin e buxhetit për vitin 2024.

“Termokos” është dashur të bëjë një vlerësim më të saktë të tregut, duke siguruar mjete të mjaftueshme për iniciimin e këtij aktiviteti të prokurimit konform rrethanave të tregut, në mënyrë që të mundësojë konkurrencën dhe ofertimin e më shumë operatorëve ekonomikë të interesuar. Kjo dëshmohet me faktin se kompania e cila kishte kërkuar rritjen e buxhetit për këtë tender, nuk oferto fare pas përgjigjes së AK-së se shumica e ndarë për këtë projekt ishte e mjaftueshme. Kjo ngrit dyshimet se AK qëllimisht ka kufizuar konkurrencën duke vendosur fillimisht një vlerë të parashikuar e cila nuk përkonte me çmimet në treg, duke bërë që të ulët numri i ofertueseve e pastaj pas mbylljes së ofertave, ka rritur shumën për këtë tender për operatorin ekonomik fitues. Shkalla e lartë e interesimit për këtë tender dëshmohet nga fakti se 99 operatorë ekonomikë kanë shkarkuar Dosjen e Tenderit, ndërsa numri i ulët i ofertuesve (vetëm 3), tregon se konkurrenca ishte e bllokuar nga çmimi i kuotuar dhe kërkesat teknike që nuk përdoren më.

Përveç ndikimit negativ në konkurrencë, që është mekanizimi që siguron kontraktimin e çmimeve më të lira, tejkalimi i shumës së planifikuar pritet të ndikojë në projektet e tjera të planifikuara për vitin 2024, nga të cilat do të hiqen mjetet të cilat do të zotohen për këtë projekt.

2. Bifurkacioni

2.1. Zvogëlimi i humbjeve të ujit dhe digjitalizimi i shërbimeve

Kompania regjionale e ujit dhe kanalizimit “Bifurkacioni” është ndërmarrje publike që ofron shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe mbledhjen e ujërave të zeza për komunitetet e Ferizajt dhe Kaçanikut.

Në fund të muajit tetor të 2023, kjo ndërmarrje hapi tenderin për zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe digjitalizimit të shërbimeve, i ndarë në dy lote: LOT 1 – Furnizim dhe instalim i kapakëve të pusëve për ujëmatës dhe furnizim me ujëmatës dhe LOT 2 – Digjitalizim i shërbimeve, në vlerë të parashikuar të kontratës 111,500.00 euro.

Kjo ndërmarrje shkurtoi afatin kohor për dorëzimin e tenderëve në 11 ditë, nga 20 ditë sa parashihet të jetë i hapur në rastet kur zbatohet procedura e hapur të kontratave publike të cilat nuk janë me vlerë të madhe. Në arsyetimin e dhënë të Njoftimit për Kontratë, thuhet se kjo kërkesë për shkurtime u bë nga njësi kërkuuese me qëllim që të zbatohet procedura e shpejtuar sepse projekti duhej të përfundonte gjatë vitit fiskal 2023.


LPP parasheh rregulla të posaçme për mundësimin e shkurtimeve të afateve kohore për dorëzimin e ofertave, nëse ekzistojnë rrethanat që kërkojnë zbatimin e një aktiviteti të prokurimit në raste urgjente të parapara në nenin 46⁷. Megjithatë, çfarëdo afati kohor për pranimin e tenderëve, duhet të iu mundësojë operatorëve të interesuar ekonomikë kohë të mjaftueshme për përgatitjen e ofertave kundrejt Dosjes së Tenderit. Zyra e Prokurimit të kësaj ndërmarrjeje, në një përgjigje për D+, theksoi se arsyeja e shkurtimeve të afatit për dorëzimin e ofertave ishte financimi/donacioni i këtij aktiviteti nga Qeveria e Kosovës, ndaj i njëjti duhej të realizohej para përfundimit të vitit kalendarik.

Për këtë aktivitet të prokurimit, AK ofroi përgjigje për informacione shtesë katër herë, duke publikuar formularin standard për korrigjimin e gabimeve me datën 06.11.2023, dokument me të cilin edhe njoftoi shtyrjen e afatit për dorëzimin e ofertave për katër ditë.

Ndonëse afati për dorëzimin e ofertave u shty për katër ditë pas publikimit të informatave sqaruese, i njëjti u publikua në datën që fillimisht ishte paraparë të ishte afati i fundit për dorëzimin e tenderëve, ndaj në këtë situatë, AK obligohej ta zgjaste afatin për dorëzimin e tenderëve për së paku 10 ditë nga dita në të cilin janë dhënë informatat sqaruese. Kjo gjë është përcaktuar në LPP⁸ dhe Rregulloren, ku thuhet se:

7 Ligji Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës. Neni 46: Rregullat e posaçme për mundësimin e shkurtimeve të afateve kohore. Gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772> (qasur për herë të fundit me 14.11.2023).

8 Ligji Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës. Neni 53.7: Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit. Gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772> (qasur për herë të fundit me 14.11.2023).



“Nëse, gjatë një procedure të hapur, të kufizuar apo konkurruese me negociata, informata shtesë apo sqaruese ofrohen për OE-të, dhe data kur ofrohen këto informata është më pak se dhjetë (10) ditë nga afati i fundit për dorëzim të tenderit, AK do të zgjatë afatin kohor për të dhënë mundësi OE të paktën 10 ditë për dorëzimin e tenderëve duke përgatitur dhe publikuar Njoftimin për Korrigjim të procedurës”⁹.

Shkurtimi i afatit shtesë për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave në vetëm katër ditë është në shpërputhje me LPP-në dhe Rregulloren e Prokurimit Publik, dhe ky shkurtim kufizon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomikë, të cilët nuk kanë kohë të mjaftueshme për dorëzimin e ofertave.

Në Dosjen e Tenderit, AK kërkoi implementimin, zhvillimin, ofrimin e zgjidhjes për Aplikacionin Mobil (aplikacioni i cili duhet të ketë mundësinë e pagesave online, të përmbajë një pasqyrë të përgjithshme të konsumatorit, kartela e shpenzimeve, lajmërimet, ankesat dhe kërkesat), dhe zhvillimin e zgjidhjes për ndërlidhjen e sistemit të pagesave dhe faturimit në kohë reale me institucionet e tjera (e-Kosova, institucionet buxhetore, institucionet bankare, agjencitë financiare).

Në pyetjen sqaruese të datës 02.11.2023, se a e posedon autoriteti kontraktues kodin burimor të sistemit të faturimit aktual dhe sistemeve tjera që janë të ndërlidhura me këtë digjitalizim, AK është përgjigjur se sistemi aktual i faturimit ka qenë donacion dhe se nuk e posedojnë kodin burimor.

Në këtë situatë, sistemi aktual i faturimit dhe kodi burimor i këtij sistemi janë pjesë esenciale të programit të cilat janë krijuar nga një kompani dhe ky kod konsiderohet si pronësi intelektuale. Duke qenë se krijuesi i këtij kodi ose subjekti që e zotëron të drejtën e autorit ka të drejtën ekskluzive për të riprodhuar, shpërndarë ose modifikuar kodin, dhe me faktin që AK ka pranuar se nuk posedon kodin burimor, atëherë realizimi i kësaj kërkesë bëhet i pamundur duke qenë se askush tjetër nuk ka qasje në këtë kod, dhe i paligjshëm pasi askush tjetër përveç krijuesit të programit nuk ka autorizim të bëjë një gjë të tillë.

Krijimi i një sistemi të ri nga fillimi ose kontraktimi i kompanisë e cila ka në zotërim kodin përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, janë mundësitë e vetme për realizimin e këtij qëllimi teksa kërkesa e AK-së përjashton të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar të cilët nuk janë pronarë të këtij kodi.

⁹ Rregullore nr.001/2022 për Prokurimin Publik. Neni 24.5. Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve dhe zgjatjet e afateve kohore. Gjetend në https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf (qasur për herë të fundit me 21.11.2023).

3. Trafiku Urban

3.1. Furnizimi me kompjuter

Ndërmarrja publike komunale, "Trafiku Urban" që ofron shërbime në transportin publik, hapi tenderin për furnizim me kompjuter (nr. të prokurimit TU-23-1560-1-2-1), me qëllim të blerjes të disa pajisjeve elektronike si: kompjuter, laptop, tablet, telefona mobil, etj.

Vlera e parashikuar e këtij aktiviteti të prokurimit ishte 30,100.00 euro, ndërsa kontrata u lidh në vlerë prej 29,861.00 euro me operatorin ekonomik AXA Sh.P.K., me AK-në që përdori kriter të dhënies çmimin më të ulët. Ky aktivitet i prokurimit u zhvillua me procedurë të hapur, dhe ndonëse kishte numër të lartë të kërkesave për tërheqjen e Dosjes së Tenderit (40), vetëm dy operatorë ekonomikë dorëzuan oferta.

TABELA 2. Operatorët ekonomikë dhe vlera e ofertave

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera totale e ofertave
1.	AXA Sh.P.K.	29,861.00 euro
2.	Aritech Sh.P.K	25,337.00 euro

Operatori tjetër ofertues, Aritech Sh.P.K., kishte ofertë më të lirë, por u eliminua si tender i papërgjegjshëm administrativisht mbi bazën se nuk arriti të plotësoi kërkesat mbi mundësitë teknike/profesionale, duke mos dorëzuar autorizimet MAF (autorizimin nga prodhuesi)/DAF (dileri i autorizuar nga prodhuesi), si dhe sigurimin e tenderit prej 1000 euro të vlefshëm 90 ditë.

Në Dosjen e Tenderit u specifikua se autorizimet MAF ose DAF, me referencë të tenderit kërkoheshin vetëm për pozicionet një deri në katër të paramasës.

TABELA 3. Pozicionet e paramasës për të cilat kërkohet autorizimi MAF ose DAF

Nr.	Përshkrimi i produktit	Sasia
1.	All in One PC 24"	32 copë
2.	Laptop Brand Name	1 copë
3.	Telefon Mobil	1 copë
4.	Tablet	1 copë

Në specifikimet teknike të detyrueshme të cilat gjenden në Ankesin 1 të Dosjes së Tenderit, “Trafiku Urban” kërkoi specifikacione teknike të cilat i referohen prodhimeve të caktuara, gjë që është e ndaluar me LPP¹⁰, pasi specifikat teknike duhet të hartohen që të ofrojnë qasje sa më të lehtë për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar për ofertim.

Në dimensionin e parë, ku janë kërkuar 32 All in One PC 24”, AK ka vendosur specifikacione teknike të cilat janë të veçanta vetëm për markën HP, konkretisht produktin HP All-in-One 24-cb1341nh All-in-One PC¹¹. Ndonëse nuk është përmendur emri i brendit apo lloji, detajimi i këtyre specifikave korrespondon me vetëm këtë produkt, i cili është ofruar nga operatori ekonomik fitues. Pra, të gjithë specifikat e kërkuara për këtë pozicion gjenden në këtë produkt, për faktin se këto specifika janë marrë nga ky produkt. AK është veçanërisht e ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë¹², që në këtë rast janë kompanitë të cilat nuk kanë përfaqësi/autorizim të kësaj marke.

Situata e njëjtë me markën HP paraqitet edhe me dimensionin e dytë ku është kërkuar një laptop, ndërkohë në dimensionet tre dhe katër, ku u kërkuar një telefon mobil dhe një tablet, AK paraqiti specifikat teknike të produkteve iPhone 14 Pro Max dhe iPad 10th gen. Ndonëse nuk përmendet modeli, vërehet qartë se është bërë përshkrimi i specifikave unike të tyre.

Udhëzuesi i Prokurimit Publik definon qartë se përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime është e ndaluar¹³. LPP parasheh që në kushte të jashtëzakonshme, AK mundet të hartojë specifikime teknike nëse në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës, me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët “ose ekuivalent”¹⁴.

Megjithatë, as ky opsion nuk do të ishte e mundur në këtë rast, pasi AK në specifikimet teknike iu është referuar një teknologjie të një brendi, si p.sh te specifika e procesorit në pozicionin e tretë, është kërkuar të jetë A14 Bionic chip¹⁵, që është qip i prodhuar nga Apple Inc. në shtator të vitit 2020, dhe i cili përdoret vetëm nga modelet e kësaj kompanie, në këtë rast iPad 10.9 (gjenerata e 10-të).

Kërkesa për produkte të caktuara të cilat i takojnë vetëm një brendi, kombinuar me kërkesën që ofertat të kenë autorizimin e prodhuesit apo dillerit për këto produkte, favorizon një apo më shumë operatorë ekonomikë të cilët kanë përfaqësinë ekskluzive për këto produkte, duke diskriminuar operatorët e tjerë të interesuar dhe në të njëjtën kohë ngrit dyshimin për kurdisje të tenderit.

“Trafiku Urban” me hartimin e këtyre specifikave ka shkelur LPP-në, i cili përcakton me saktësi se si duhet të hartohen specifikime teknike dhe në rastet si ky, kur autoriteti kontraktues dëshiron të zgjedhë ofertën që ofron vlerën më të mirë për parandë, që nënkupton kombinimin midis cilësisë (duke iu referuar elementeve që nuk lidhën me koston), dhe çmimit (duke iu referuar elementeve në lidhje me koston), AK mund të autorizojë përdorimin e varianteve në Dosjen e Tenderit, duke përdorur kriter të dhënies çmimit ekonomikisht më të favorshëm, por në secilin rast duhet të largojë referimin për një prodhim/marke të caktuar.

10 Ligji Nr.04/L-042 Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës. Neni 28. Gjetendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772> (qasur për herë të fundit me 20.10.2023).

11 HP Customer Support - Knowledge Base: Gjetendet në: <https://support.hp.com/lv-en/document/c08450622> (qasur për herë të fundit me 20.10.2023).

12 Ligji Nr.04/L-042 Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës. Neni 28 pika 2. Gjetendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772> (qasur për herë të fundit me 20.10.2023).

13 Udhëzuesi Nr.001/2023 për Prokurimin Publik. Neni 5.5. Gjetendet në https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/SecondaryLegislation/shq/A02_Udhezues%20Nr-001_2023%20per%20prokurimin%20publik.pdf (qasur për herë të fundit me 20.10.2023).

14 Ligji Nr.04/L-042 Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës. Neni 28. Gjetendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772> (qasur për herë të fundit me 20.10.2023).

15 All-new iPad Air with advanced A14 Bionic chip available to order starting today. Gjetendet në <https://www.apple.com/pl/newsroom/2020/10/all-new-ipad-air-with-advanced-a14-bionic-chip-available-to-order-starting-today/> (qasur për herë të fundit me 20.10.2023).

4. Pallati i Rinisë

4.1. Renovimi dhe funksionalizimi i Fontanës në Pallatin e Rinisë

Ndërmarrja publike lokale “Pallati i Rinisë”, si qendër multifunktionale, në korrik të vitit 2023 hapi tenderin për renovim dhe funksionalizim të fontanës në Pallatin e Rinisë në vlerë të parashikuar 95,000.00 euro.

Në këtë tender për punë, në të cilin u përdor procedura e hapur, ofertuan katër operatorë ekonomikë.

TABELA 4. Operatorët ekonomikë dhe vlera e ofertave

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera totale e ofertës
1.	Limitproject Sh.P.K.	94,988.21 euro
2.	Eing Com Sh.P.K.	123,878.78 euro
3.	Termo Solar Ingeenering Sh.P.K.	84,790.39 euro
4.	A& F Construction Sh.P.K	92,947.11 euro

Pas vlerësimit të tenderit, Pallati i Rinisë, rekomandoi për kontratë operatorin ekonomik Termo Solar Ingeenering Sh.P.K., me vlerë të përgjithshme të kontratës 84,790.39 euro, si tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Operatori ekonomik ofertues, Eing Com Sh.P.K., u eliminua ngase vlera totale e ofertës tejkaloi vlerën e parashikuar të kontratës, ndërkohë A& F Construction Sh.P.K., u eliminua për shkak se nuk ishte prezent në vizitë në vend punishte, kërkesë kjo e cila ishte obligative në Dosjen e Tenderit.

“Me datën 20.07.2023, organizohet nga “Pallati i Rinisë” vizita për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar, ku do të evidentohen të gjithë pjesëmarrësit e interesuar. Ju njoftojmë se mos pjesëmarrja në vend punishte me datën e lartëcekur do të rezultojë në refuzim të ofertës”.

Operatori ekonomik Limitproject Sh.P.K., parashitri kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të “Pallatit të Rinisë”, me pretendimin se ishin shkelur disa dispozita të LPP-së në rastin e rekomandimit për kontratë të Termo Solar Ingeenering Sh.P.K.

“Pallati i Rinisë” aprovoi pjesërisht kërkesën duke konstatuar se Komisioni për vlerësimin e tenderit nuk i kishte respektuar kërkesat e AK-së të përcaktuara në Njoftimin për kontratë, më saktësisht kërkesën për posedimin e kapacitetit teknik/profesional, duke rekomanduar për kontratë operatorin i cili nuk kishte përmbushur kushtet e kualifikimit. “Pallati i Rinisë” ktheu lëndën në ri-vlerësim, ku pastaj kërkoi nga Termo Solar Ingeenering Sh.P.K., plotësimin e dokumentacionit përmes kërkesës standarde për sqarimin e tenderit, duke kërkuar:

- Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike në pajtim me kërkesën 1.
- Listën e stafit profesional duke përfshirë të gjitha kërkesat për staf në pikën 4 të kërkesës.
- CV për teknikun e makinerisë si dhe dëshmitë tjera lidhur me posedimin e stafit profesional.

Pas ri-vlerësimit, “Pallati i Rinisë”, përsëri rekomandoi për kontratë Termo Solar Engineering Sh.P.K., ndërkohë refuzoi kërkesën e dytë për ri-shqyrtim të Limitproject Sh.P.K., si të pabazuar.

Pas kërkesës për sqarim, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë bashkangjiti dokumentin “Deklaratë për përputhshmëri me specifikime teknike nga Aneksi 1 dhe afatin e liferimit të artikujve”.

Duke qenë se në Dosjen e Tenderit, te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale kërkoheshin deklarata me shkrim e nënshkruar dhe e vulosur mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, si dhe deklarata për planin dinamik për kryerjen e punëve, Pallati i Rinisë nuk është dashur të kërkojë sqarim shtesë për mungesën e deklaratës për specifikacione teknike, duke u bazuar në nenin 10.1 të Udhëzuesit për Prokurimin Publik¹⁶, i cili në këtë situatë thotë se tenderi duhet refuzuar pa kërkuar informacione të mëtejshme.

“Pallati i Rinisë” nuk veprroi në harmoni me kërkesën e Dosjes së Tenderit duke qenë se bëhej fjalë për ndryshime esenciale nga oferta e dorëzuar.

Kjo lëndë u apelua në Organin Shqyrtues të Prokurimit, i cili anuloi vendimin e Pallatit të Rinisë për rekomandim për kontratë të Termo Solar Engineering Sh.P.K., duke e kthyer lëndën në rivlerësim.

¹⁶ Udhëzues Nr.001/2023 për Prokurimin Publik. Mund të gjendet: https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/SecondaryLegislation/shq/A02_Udhezues%20Nr-001_2023%20per%20prokurimin%20publik.pdf (qasur për herë të fundit me 20.10.2023).

Të gjeturat

Termokosi:

- Ndërmarrja publike “Termokosi” shkurtoi afatin për dorëzimin e ofertave, pavarësisht se me ligj është përcaktuar dhe specifikuar afati minimal që duhet t’u lihet operatorëve ekonomikë për përgatitjen e ofertave.
- “Termokosi” vendosi kriter certifikatën OHSAS 18001, e cila nuk është e vlefshme që nga viti 2018, dhe nga shatori i 2021, asnjë operatorë ekonomikë nuk ka pasur mundësi të pajisjet me këtë certifikatë.
- Kjo ndërmarrje nënshkroi kontratë për 233,753.60 euro më shumë sesa që ishte vlera e parashikuar, ndonëse u paralajmërua nga operatorët ekonomikë gjatë fazës së ofertimit se çmimi i parashikuar nuk korrespondonte me çmimet e tregut.
- Kjo ndërmarrje publikoi emrin e operatorit ekonomik me rastin e dhënies së përgjigjes për informatat sqaruese, duke shkelur nenin 45.11 të Rregullores së Prokurimit Publik.

Bifurkacioni:

- “Bifurkacioni” shkurtoi afatin kohor për dorëzimin e ofertave në 11 ditë, nga 20 ditë sa parashihet të jetë i hapur në rastet kur zbatohet procedura e hapur të kontratat publike të cilat nuk janë të vlerës së lartë.
- Me rastin e publikimit të informatave sqaruese, ky AK shtyu afatin për dorëzimin e ofertave për katër, teksa obligohej që ky afat të zgjatej për së paku 10 ditë.

- Kjo ndërmarrje kërkoi ndryshime në sistemin e faturimit, teksa kjo gjë është e pamundur të bëhet nga operatorët ekonomikë pasi AK nuk zotëron kodin burimor të sistemit aktual.

Trafiku Urban:

- “Trafiku Urban” kërkoi kompjuter me specifika unike për një markë, duke mos lejuar variantet apo produkte ekuivalente.
- Kjo ndërmarrje vendosi specifikacione teknike të cilat favorizojnë, ose diskriminojnë një apo më shumë operatorë ekonomikë, që në këtë tender janë kompanitë të cilat nuk kanë përfaqësi/autorizim të markës së kërkuar.
- “Trafiku Urban” kërkoi tablet dhe telefonë, duke përmendur specifikat që i kanë vetëm modelet e kompanisë “Apple”.

-

Pallati i Rinisë:

- “Pallati i Rinisë” kërkoi plotësimin e dokumentacionit përmes kërkesës standarde për sqarimin e tenderit për operatorin ekonomik i cili duhej eliminuar direkt, pa kërkuar sqarime shtesë.
- Kjo ndërmarrje publike nuk trajtoi kërkesën për rishqyrtim konform Udhëzuesit të Prokurimit Publik, i cili në mënyrë të qartë shpjegon veprimet që duhet ndërmarrë në rastet kur ka ndryshime esenciale të ofertës.

Rekomandimet

1. Ndërmarrjet publike, në cilësinë e autoriteteve kontraktuese duhet të respektojnë afatet ligjore për dorëzimin e ofertave siç përcakton LPP, dhe të bëjnë përpjekje maksimale që të evitojnë shkurtimin e tyre, në mënyrë që operatorëve ekonomikë t'u mundësohet koha e nevojshme për përgatitje të dokumenteve dhe kështu të sigurohen kushtet për konkurrencë.
2. Autoritetet kontraktuese të mos kërkojnë certifikata diskriminuese apo favorizuese, të cilat nuk përdorën më, ose nuk janë relevante me natyrën e tenderit dhe janë në dëm të konkurrencës së lirë mes operatorëve ekonomikë.
3. Autoritetet kontraktuese të sigurohen maksimalisht që parashikimet për vlerën e kontratave të jenë në harmoni me çmimet e tregut, duke u kujdesur që të mos lidhin kontrata më të larta sesa buxheti i ndarë për to.
4. Autoritetet kontraktuese të mos vendosin specifika teknike të cilat janë të veçanta për një produkt/model, duke qenë se kjo gjë është e ndaluar me LPP dhe është në dëm të konkurrencës së lirë mes operatorëve ekonomikë.
5. Autoritetet kontraktuese të mos publikojnë emrat e operatorëve ekonomikë në rastet kur japin përgjigje për informata sqaruese për tender.
6. Në rastet kur autoritetet kontraktuese publikojnë informata sqaruese në lidhje me tenderë, të shtyjnë afatin e fundit për dorëzimin e ofertave në mënyrë që t'u mundësohet kohë e mjaftueshme operatorëve ekonomikë që të bëjnë përshtatjen e ofertave karshi ndryshimeve në Dosjen e Tenderit. entohet nga Demokraci Plus (D+).



Financuar nga
Bashkimi Evropian

